

KËSHILLI I SIGURISË SË KOSOVËS

REFORMIMI I SEKRETARIATIT APO
KRIJIMI I AGJENCISË PËR SIGURI

Këshilli i Sigurisë së Kosovës: Reformimi i Sekretariatit apo krijimi i Agjencisë për Siguri

Ky raport është mbështetur nga:
Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analizat në këtë raport janë vetëm të Grupit për Ballkan dhe nuk reflektojnë qëndrimin e donatorit.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
REKOMANDIME	5
HYRJE	6
KËSHILLI I SIGURISË SË KOSOVËS	7
PËRBËRJA E KËSHILLIT TË SIGURISË SË KOSOVËS	8
STRUKTURA AKTUALE ORGANIZATIVE E KËSHILLIT TË SIGURISË SË KOSOVËS	8
REFORMIMI I ORGANEVE TË KSK-së	12
Riorganizimi i Sekretariatit dhe kompetencave të udhëheqësve të tij	12
Shndërrimi i Sekretariatit të KSK-së në Agjenci ekzekutive brenda Zyrës së Kryeministrit	15
FUNKSIONIMI I KËSHILLAVE TË SIGURISË NË VENDET E TJERA	19
PËRFUNDIME	22

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zhvillimi i politikave të sigurisë dhe mënyra e koordinimit të institucioneve dhe agjencive shtetërore në zbatimin e tyre, ka rol fundamental në suksesin apo dështimin e vendit në ballafaqimin me rreziqe apo kërcënime të sigurisë nacionale. Kushtetuta e Kosovës ia ka atribuar Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK) këtë rol, si institucioni më i lartë këshillëdhënës. Këshilli kryesohet nga Kryeministri i Qeverisë së Kosovës. Në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, e deri në kalimin e asaj gjendjeje, Këshilli merr kompetenca ekzekutive dhe kryesia i kalon Presidentit/es së vendit.

Prandaj, është shumë e rëndësishme që funksionimi i KSK-së të jetë në nivel të përmbushjes së detyrave dhe të jetë i konsoliduar në mënyrë të plotë. KSK-ja duhet të jetë në gjendje të ofrojë këshilla dhe politika të cilat për nga përmbajtja janë kredibile për të gjitha institucionet dhe agjencitë që përbëjnë sektorin e sigurisë në vend.

Deri më tani funksionimi i KSK-së është përcjellë me probleme të mëdha të cilat vazhdojnë të ndikojnë në përmbushjen e detyrave të këtij institucioni. Këshillit i mungon koordinimi efikas ndërinstytucional, kompetencat e kufizuara të Sekretarit dhe mungesa e kapaciteteve Sekretariatit të KSK-së, si dhe mungesa e një mekanizmi i cili do të udhëhiqte apo koordinonte të gjitha aktivitetet dhe i cili do të përfaqësonte drejtpërsëdrejti nivelin strategjik e politik të ekzekutivit, kryeministrit dhe qeverisë së Kosovës.

Që nga themelimi i KSK-së, asnjë nga qeveritë e deritanishme nuk ka shfaqur gatishmëri e as vullnet për ta konsoliduar plotësisht këtë institucion të rëndësishëm. Shpesh, Këshilli është anashkaluar, dhe mungesa e mbështetjes politike e institucionale i ka shkaktuar probleme funksionale, duke e lënë atë me kapacitete shumë të kufizuara. Si pasojë e kësaj situatë të vazhdueshme, është krijuar një hendek i madh i moskoordinimit dhe komunikimit në mes institucioneve përbërëse në Këshill.

Këto mangësi më së shumti janë vërejtur tek organet mbështetëse të KSK-së, përkatësisht tek Sekretariati i tij. Si rezultat i kësaj, Sekretariati ka dështuar të përmbushë detyrat e tij siç janë përgatitja e raporteve periodike dhe analizave për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, hartimin e strategjisë dhe politikave të sigurisë, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve.

Mangësi tjetër që po ndikon në funksionimin e KSK-së është edhe mungesa e ligjit për gjendjen e jashtëzakonshme. Kushtetuta shprehimisht thekson se në rastet e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme KSK-ja merr kompetenca ekzekutive; aktualisht mungon rregullativa ligjore për kompetencat si dhe për vetë organizimin dhe funksionimin e Këshillit në raste të tilla.

Për t'i adresuar të gjitha këto mangësi si dhe për ta funksionalizuar plotësisht Këshillin e Sigurisë duhet të ndërmerren një varg veprimesh politike, ligjore e administrative. Këto veprime kërkojnë riorganizimin e pjesës administrative të Këshillit, përkatësisht Sekretariatit dhe strukturës së tij, duke e avancuar atë në nivel më të lartë ekzekutivo-operacional. Këto reforma mund të shkojnë në dy drejtime; në riorganizimin e Sekretariatit dhe kompetencave të udhëheqësve të tij në kuadër të kornizës ligjore ekzistuese, ose shndërrimin e Sekretariatit të KSK-së në Agjenci ekzekutive brenda Zyrës së Kryeministrit. Më saktësisht, Sekretariati mund të shndërrohet në Agjenci për Siguri Kombëtare apo në Agjenci për Siguri e cila do të vepronte në kuadër të zyrës së Kryeministrit. Po kaq i rëndësishëm është edhe miratimi i Ligjit për Gjendjen e Jashtëzakonshme. Vetëm me ndërmarrjen e këtyre veprimeve përfshirë edhe ato politike, KSK-ja mund të bëhet më funksionale dhe e përgatitur për t'u ballafaquar me çështjet e sigurisë për t'ju përgjigjur nevojave të vendit.

REKOMANDIME

Për ta fuqizuar rolin e Këshillit të Sigurisë, së pari nevojitet reformimi (ndryshimi) i Sekretariatit si trup administrativ e teknik. Këto ndryshime mund të bëhen në dy drejtime:

I) Riorganizimi i Sekretariatit dhe kompetencave të udhëheqësve të tij

Ky veprim kërkon ndryshime minimale në ligjet ekzistuese mbi të cilat funksionon Sekretariati, ashtu që:

- Pozita e sekretarit të shndërrohet në pozitë të Drejtorit, i cili duhet të emërohet drejtpërdrejtë nga Kryeministri. Drejtori i Sekretariatit njëkohësisht do të shërbente edhe si këshilltar për Siguri i Kryeministrit.
- Të krijohet pozita e zëvendësdrejtorit apo e zëvendëssekretarit, i cili do të ofrojë mbështetje administrative e funksionale për Sekretariatit dhe KSK-në. Zëvendëssekretari duhet të zgjedhet përmes procedurave të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publik, në mënyrë që të ruhet memoria institucionale e Sekretariatit të KSK-së.

II) Shndërrimi i Sekretariatit të KSK-së në Agjenci për Siguri (Kombëtare) brenda Zyrës së Kryeministrit

Kjo alternativë kërkon ndryshime më të mëdha ligjore të cilat do të mundësonin:

- Shndërrimin e Sekretariatit në Agjenci Ekzekutive - Agjenci për Siguri në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Agjencia do të udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv i cili do të jetë përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e saj. Drejtori i Agjencisë duhet të emërohet me vendim të Kryeministrit dhe t'i përgjigjet drejtpërdrejtë atij. Këto ndryshime kërkojnë amandamentimin e Ligjit për Themelimin e KSK-së, si dhe miratimin e një ligji të ri për krijimin e Agjencisë.
- Zëvendësdrejtori i Agjencisë duhet të emërohet sipas procedurave të parapara për emërimin e zyrtarëve të nivelit të lartë drejtues siq e parasheh Ligji për Zyrtarët Publik.

Në të dy rastet, kërkohen veprime shtesë për të rritur kapacitetet e Sekretariatit apo Agjencisë, veçanërisht në:

- Funkcionalizimin dhe ngritjen e kapaciteve për Qendrën e Situatave
- Krijimin e Departamentit për Analiza dhe Politika të Sigurisë
- Pajisjen e obligueshme me leje të sigurisë për të gjithë punonjësit e institucionit ashtu siç e përcakton legjislacioni i fushës
- Ngritjen e kapaciteteve profesionale në të gjitha nivelet e Sekretariatit apo Agjencisë.

HYRJE

Sektori i sigurisë përbëhet nga një numër institucioneve dhe mekanizmash kompetencat dhe roli i të cilave përcaktohet me Kushtetutë, ndërsa funksionimi dhe zbatimi në praktikë i këtyre kompetencave rregullohet përmes ligjit dhe rregulloreve. Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK) është një prej institucioneve më të rëndësishme në sektorin e sigurisë. Ai shërben si institucion këshillues për të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e vendit.¹

Bazuar në Ligjin për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, roli i tij është këshillues, diskutues, vlerësues dhe rekomandues për çështjet e sigurisë së vendit.² Edhe pse KSK-ja udhëhiqet nga Kryeministri, roli i tij është dytësor në krahasim me ekzekutivin.

Këshilli i Sigurisë së Kosovës është përgjegjës për hartimin e Strategjisë së Sigurisë së Kosovës.

Megjithatë, ekziston një rast kur roli i KSK-së zgjerohet dhe merr karakter ekzekutiv. Në rastin e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme nga ana e Presidentit, kryesimi i KSK-së kalon tek Presidenti i vendit, me ç'rast edhe anëtarët e tij me rol këshillëdhënës bëhen anëtarë të rregullt të Këshillit.³ Në mungesë të Ligjit për Gjendjen e Jashtëzakonshme mbetet e paqartë se çka konkretisht ndodhë me kompetencat e KSK-së dhe anëtarëve të tij, përkatësisht cili është roli i Këshillit në rastet e Gjendjes së Jashtëzakonshme. Duke marrë parasysh rëndësinë e institucionit të KSK-së në sektorin e sigurisë së vendit, është shumë e rëndësishme që funksionimi i tij të koncentrohet në krijimin e mundësive për vendimmarrje të bazuar në efikasitet dhe efektivitet të politikave të sigurisë së Kosovës.

Për të përmbushur misionin e vet, KSK-ja duhet të shërbejë si organ i cili në mënyrë përmbajtësore do të ofrojë politika të mirëvlerësuara për institucionet dhe agjencitë që janë pjesë përbërëse e sektorit të sigurisë së vendit. Andaj, është nevojë e domosdoshme që të përmirësohet funksionimi i KSK-së, të rritet struktura e Këshillit, të ngriten kapacitetet e tij profesionale e administrative të rritet buxheti, etj. Edhe më shumë e rëndësishme është ristrukturimi i strukturës udhëheqëse së Këshillit për të krijuar një komunikim të mirëfilltë me Kryeministrin.

Funksionimi i KSK-së deri më sot ka shfaqur probleme të konsiderueshme të cilat vazhdojnë të ndikojnë në përmbushjen e detyrave të këtij institucioni. Ndër më të theksuarat janë: mungesa e koordinimit efikas ndër-institucional në mes të institucioneve të sigurisë në baza ditore dhe periodike, fuzionimi i kontributeve të të gjithë akterëve të sektorit të sigurisë, koordinimi i aktiviteteve të përbashkëta në mes të këtyre institucioneve, roli dhe kompetencat e kufizuara të Sekretarit të Sekretariatit të KSK-së si dhe mungesa e Ligjit për Gjendjen e Jashtëzakonshme.

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 127, fq.52

² Ligji për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, shih nenin 1.1, 1.2 dhe 1.3

³ Po aty, shih Kreun II, nenet 12 - 15

KËSHILLI I SIGURISË SË KOSOVËS (KSK)

Këshilli i Sigurisë së Kosovës është organ kushtetues që ka rol këshillues në të gjitha çështjet që lidhen me aspektet e sigurisë në Kosovës. Kapitulli i IX i Kushtetutës mbi Sektorin e Sigurisë, neni 127, përcakton: “Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë, përgatitë strategjinë e sigurisë për Republikën e Kosovës. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës ka edhe rol këshillues në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në Republikën e Kosovës”.⁴

KSK-ja përgatitë dhe rekomandon politikat dhe strategjitë për sigurinë si dhe rekomandon dhe vlerëson, në vazhdimësi dhe në kohë reale, gjendjen e sigurisë në vend. Veprimet e lartcekura i mundësojnë Qeverisë së Kosovës marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me çështjet e sigurisë së vendit si dhe sigurimin e stabilitetit rajonal.

Ndër kompetencat më të rëndësishme të KSK-së është përgatitja dhe shqyrtimi i Strategjisë së Sigurisë së Kosovës, proces ky i cili bëhet në koordinim të plotë me Presidentin e vendit.

KSK-ja gjithashtu ofron komente dhe këshilla për të gjitha institucionet e sigurisë si dhe në hartimin e projektligjeve të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e vendit. Para miratimit në Qeveri, KSK shqyrton planin qeverisës dhjetëvjeçar të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), platformën vjetore të inteligjencës dhe prioritetet strategjike të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI)-së, politikat dhe planet strategjike të Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me Policinë e Kosovës si dhe me Doganat e Kosovës.

KSK-ja kryesohet nga Kryeministri. I gjithë procesi i mbajtjes së takimeve, duke filluar prej kryesimit, thirrjes, përcaktimit të rendit të ditës dhe raportimit është kompetencë e Kryeministrit, përveç në rastet e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme në vend.

Në rastet e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme “Presidenti i Republikës së Kosovës mund të kërkojë takime të Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës, dhe Këshilli është i obliguar të bashkërendojë punën e tij ngushtësisht me Presidentin. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtësisht me autoritetet ndërkombëtare”.⁵

Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, KSK-ja ushtron autoritet dhe merr përgjegjësi ekzekutive në emër të Qeverisë. Në këtë rast e deri në kalimin e situatës emergjente, KSK-ja kryesohet nga Presidenti/ja i/e vendit.

Ky kapërcim i kompetencave, nga roli këshillëdhënës në rol ekzekutiv, na vë në dukje sa i domosdoshëm është miratimi i Ligjit për Gjendjen e Jashtëzakonshme i cili do të qartësonte më tutje kompetencat dhe detyrimet e KSK-së gjatë kohës sa zgjatë emergjenca.

⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 127 pika 2, fq.52

⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 127, pika 3.

PËRBËRJA E KËSHILLIT TË SIGURISË SË KOSOVËS

Përbërja e KSK-së është përcaktuar me Ligjin për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.⁶ KSK-ja në përbërje të vet përfshinë anëtarë të përhershëm me autoritet ekzekutiv, pra me të drejtë vote, si dhe anëtarë të përhershëm me rol këshillëdhënës, respektivisht pa të drejtë vote.

Përbërja e Këshillit të Sigurisë së Kosovës	
Anëtarët e përhershëm ekzekutiv me të drejtë vote:	Anëtarët e përhershëm me rol këshillëdhënës dhe pa të drejtë vote:
Kryeministri; Zëvendëskryeministri(at); Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ose në mungesë të tij/ saj, Zëvendësministri(at); Ministri i Punëve të Jashtme, ose në mungesë të tij/ saj Zëvendësministri; Ministri i Punëve të Brendshme, ose në mungesë të tij/ saj Zëvendësministri; Ministri i Drejtësisë, ose në mungesë të tij/ saj Zëvendësministri; Ministri i Ekonomisë dhe Financave, ose në mungesë të tij/ saj Zëvendësministri; Ministri për Kthim dhe Komunitete, ose në mungesë të tij/ saj Zëvendësministri.	Një përfaqësues i Presidentit të Republikës së Kosovës; Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë; Këshilltari i lartë i Kryeministrit; Këshilltari i Kryeministrit për Siguri, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës; Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës; Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës; Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Drejtori i Doganave të Republikës së Kosovës.

Fig 1. Përbërja e KSK-së

Varësisht nga situata dhe gjendja emergjente, përbërja e KSK-së me vendim të kryesuesit mund të plotësohet me anëtarë të tjerë të cilët nuk marrin rol ekzekutiv dhe të cilët janë anëtarë të përkohshëm.

Për shembull, në rast të ndonjë katastrofe natyrore, kryesuesi mund të thërrasë në takim të KSK-së ministrin përgjegjës, drejtorët e agjencive apo departamenteve fushëveprimtaria e të cilëve është prekur dhe ka pësuar nga katastrofa. Përveç kësaj, ashtu si në rastin e Pandemisë COVID-19, kryesuesi fton në takim të KSK-së Ministrin e Shëndetësisë së bashku me drejtorin e Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim që KSK të marrë informata dhe këshilla të drejtpërdrejta dhe më pas vendimet e tij të jenë në përputhje me situatën.⁷

STRUKTURA AKTUALE ORGANIZATIVE E KËSHILLIT TË SIGURISË SË KOSOVËS

KSK ka organet mbështetëse të cilat janë:

- Sekretariati i Këshillit të Sigurisë
- Qendra e Situatave, dhe
- Komisionet Koordinuese.

⁶ Ligji Nr. 03/L-50, neni 3.

⁷ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar qeveritar, maj 2022, Prishtinë

Sekretariati i KSK-së, kryesohet nga Sekretari dhe është përgjegjës për tri komponente kryesore të funksionimit e të cilat përfshijnë:

- Përgatitjen e raporteve periodike dhe analizave - që kanë të bëjnë me çështjet politike të sigurisë - për Qeverinë dhe KSK-në;
- Koordinimin e hartimit të strategjisë dhe politikave të sigurisë në Kosovë, përfshirë edhe rritjen e kapaciteteve, miratimin e instrumenteve të politikave dhe hulumtimit; dhe
- Mbështetjen administrative dhe funksionale të KSK-së.⁸

Organ tjetër mbështetës i KSK-së është **Qendra e Situatave**, përgjegjësi e së cilës është paralajmërimi me kohë i situatave, koordinimi i aktiviteteve reaguese operationale në mbarë vendin dhe të shërbejë si një qendër operative për grumbullimin e informatave, analizave themelore, si dhe të mbështesë menaxhimin e krizave.

Varësisht nga situata dhe çështja e cila kërkon vëmendje, kryesuesi i KSK-së mund të themelojë komisione të ndryshme koordinuese. Një ndër komisionet më të rëndësishme koordinuese si organ mbështetës i KSK-së është **Komisioni për Inteligjencë**. Ky komision themelohet nga Kryeministri dhe në përbërje ka Sekretarin e KSK-së, përfaqësuesit e lartë të Policisë së Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Forcën e Sigurisë së Kosovës, Shërbimin Doganor, dhe çfarëdo agjencie apo organizate të autorizuar e cila sipas ligjit ka mandat për kryerjen e aktiviteteve të inteligjencës.⁹ Ky komision koordinon aktivitetet e inteligjencës të organizatave dhe agjencive të lartcekura si dhe kujdeset për zbatimin e politikave të Qeverisë sa i përket sektorit të inteligjencës.




Fig 2. Struktura organizative e KSK-së¹⁰

⁸ Ligji Nr.03/L-050, neni 16, paragrafi 16.4, fq.7

⁹ Ligji Nr.03/L-050, neni 18, fq. 8

¹⁰ <https://ksk.rks-gov.net/legjislacioni/67/rregulloret>

Sekretariati i KSK-së është përgjegjës për përgatitjen e raporteve periodike dhe analizave që kanë të bëjnë me çështjet politike të sigurisë. Për të qenë në gjendje gatishmërie dhe në koordinim të plotë me të gjitha institucionet tjera relevante, Sekretariati duhet të komunikojë dhe të ndërveprojë me to në baza ditore. Sekretariati, përveç me Kryesuesin, duhet të ketë komunikim të rregullt me të gjithë anëtarët e përhershëm të KSK-së duke qenë se ata janë udhëheqësit dhe bartësit e zbatimit të politikave të sigurisë së vendit.¹¹

Komunikimi, shkëmbimi i informatave dhe planifikimi i aktiviteteve të përbashkëta me anëtarët e Këshillit, është i domosdoshëm. Mungesa apo lënja jashtë qoftë e vetëm një hallke të cilën ata përfaqësojnë, mund të reflektohet në analizën për një çështje të caktuar dhe kështu të devijojë në tërësi politikën që mëtohet të prezantohet para KSK-së, Kryesuesit dhe Qeverisë.

Kushtetuta qartazi thekson se Presidenti i vendit mund të kërkojë takime me anëtarët e KSK-së Poashtu, Këshilli është i obliguar të bashkërendojë punën e tij ngushtë me Presidentin.¹² Ky bashkërendim mund të funksionojë vetëm me komunikim në baza të rregullta ditore. Deri më tani, komunikimi në mes KSK-së dhe Presidencës është bërë përmes përfaqësuesit të institucionit të Presidentit në KSK.

Komunikimi dhe transmetimi i informatave dhe raporteve nga Sekretariati tek Kryeministri, aktualisht bëhet përmes Shefit të Stafit dhe Këshilltarit për Siguri të Kryeministrit.¹³ Marrë parasysh detyrat dhe përgjegjësitë e të lartcekurve, kjo procedurë shpesh paraqet pengesë për rrjedhën e shpejtë dhe të saktë të informacionit deri te Kryeministri. Andaj, bazuar në praktikën më të mira në rajon, dhe jo vetëm, informatat dhe koordinimi i punës së KSK-së me Kryeministrin duhet të bëhen nga dora e parë, me shpejtësinë dhe saktësinë e duhur, duke evituar kanalet tjera, të cilat shpesh shkaktojnë vonesa dhe mundësi të keqinformimit.

Sekretariati i KSK-së duhet të riorganizohet, në mënyrë që të mund të evitohen të gjitha pengesat dhe vonesat në informim të krerëve të institucioneve. Kjo do të arrihej duke vënë në krye të Sekretariatit personin e emëruar drejtpërdrejtë nga Kryeministri, në koordinimin me Presidentin e vendit, dhe i cili njëkohësisht shërben si Këshilltar për çështje të sigurisë i Kryeministrit. Ky riorganizim poashtu do të ndihmonte në ndërtimin e një mekanizmi shumë më të qëndrueshëm për vlerësimin e gjendjes dhe ofrimin e shpejtë të zgjidhjeve në situata të ndryshme, si dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura në kohë.

Të gjitha mekanizmat e sigurisë në vend, e rrjedhimisht edhe KSK-ja, janë ndërtuar pothuajse nga zero, pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Ndërtimi i tyre ka qenë i përkrahur drejtpërdrejtë nga bashkësia ndërkombëtare. Megjithatë, si rrjedhojë e presionit dhe ndërhyrjeve politike, shumica e këtyre institucioneve, përfshirë KSK-në, janë përballur me sfida komplekse.

Qeveritë e njëpasnjëshme nuk kishin vullnet dhe gatishmëri për ta konsoliduar plotësisht këtë institucion. Si rezultat, KSK-ja ka mbetur e mangët dhe e karakterizuar me shumë probleme funksionale, veçanërisht mungesa e kapaciteteve për të kryer detyrat e tij.

Komunikimi ndërmjet institucioneve të sigurisë, përbërëse të KSK-së, gjithashtu është sfiduar nga ndërhyrjet e shpeshta politike. Komunikimi është bërë duke përdorur lidhjet e drejtpërdrejta politike me krerët e këtyre institucioneve duke anashkaluar KSK-në.

Ekzistojnë disa situata shumë të ndërlikuara me të cilat është ballafaquar vendi e në të cilat KSK-ja dhe disa nga akterët e saj janë anashkaluar në tërësi. Në korrik të vitit 2011, gjatë operacionit të njëjësive speciale

¹¹ Ligji Nr.03/L-050 neni 3, fq.3

¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 127 pika 3, fq 52.

¹³ Intervistë e Grupit për Ballkan me ish këshilltar të Kryeministrit për çështje të sigurisë, maj 2022, Prishtinë

të policisë (ROSU) në veri të vendit, KSK nuk u konsultua fare. Madje edhe Presidentja e vendit ishte informuar zyrtarisht 18 orë pas fillimit të operacionit policor.¹⁴ Ngjashëm, në qershor të vitit 2015, në rastin e kërcënimeve me sulme terroriste nga eksponent të radikalizmit islamik, situata ishte menaxhuar përmes takimeve joformale mes drejtuesve të institucioneve përgjegjëse. KSK nuk kishte mbajtur takim dhe nuk ishte informuar.¹⁵

Ngjashëm, KSK-ja ishte anashkaluar nga komunikimi në mes institucioneve të sigurisë në rastin e ashtuquajtur “Gulenistat”, në vitin 2018, me ç’rast u dëbuan 6 shtetas turq duke shkelur të gjitha kriteret e parapara me ligjet e vendit.¹⁶ Sikur të ishte ftuar KSK-ja dhe në kuadër të kompetencave që ka, të analizoheshin rrethanat, të konsultoheshin ligjet dhe veprimet që duhet ndërmarrë, një operacion i tillë ndoshta nuk do të ndodhte fare. Është pikërisht roli këshillëdhënës i KSK-së i cili pas konsultimeve do të vihej në veprim duke rekomanduar procedura dhe veprime në përputhje me ligjet në fuqi.

Këto anashkalime gjatë koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe komunikimit tregojnë për shpërfillje të normave ligjore dhe rrugëve institucionale, gjë e cila ka dëmtuar dhe mund ta dëmtojë në vazhdimësi menaxhimin e sektorit të sigurisë në vend.

Një mangësi tjetër që ndikon në funksionimin e KSK-së dhe në ngritjen e nivelit të besueshmërisë së këtij institucioni është edhe mungesa e trajtimit të personelit të tij në linjë me legjislacionin me të cilin udhëhiqen personelet e institucioneve të tjera të sigurisë. Prandaj, për të shmangur ndonjë lloj rrjedhje të informacionit konfidencial duhet aplikuar sigurimi i Lejes së Sigurisë nga ana e Agjencisë së Kosovës për Intelegjencë (AKI-së) për të gjithë personelin e KSK-së pa përjashtim. Kjo gjithashtu determinon edhe një trajtim të kujdesshëm të përbërjes së KSK-së në rrethana të veçanta.¹⁷ Funksionimi i KSK-së, respektivisht Sekretariatit të tij është karakterizuar edhe me mangësi të tjera, sidomos sa i përket monitorimit të zhvillimeve të sigurisë dhe përgatitjen së analizave të duhura.

Qendra e Situatave është përgjegjëse për paralajmërimin me kohë të situatave, koordinimin e aktiviteteve reaguese operationale në mbarë vendin dhe të shërbejë si një qendër operative për grumbullimin e informatave e analizave themelore, si dhe të mbështesë menaxhimin e krizave. Por, deri më tani kjo qendër pothuajse asnjëherë nuk i ka ushtruar detyrat dhe kompetencat e saj ashtu siç e parashihet ligji, edhe pse është në funksion 24 orë. Kjo sepse shumica e institucioneve të sigurisë kanë Qendrat e Situatave përkatëse të cilat nuk komunikojnë pothuajse fare me Qendrën e KSK-së.¹⁸ Ato e konsiderojnë veten si të pavarura nga Qendra e Situatave të KSK-së dhe aktivitetet e tyre i koordinojnë vetëm me eprrorët brenda institucionit në të cilin operojnë.

Departamenti për Analiza dhe Politika të Sigurisë - Ky departament nuk posedon pothuajse fare kapacitete për përgatitjen e analizave, hartimin e politikave dhe analizave në mbështetje të KSK-së. Për më tepër neni i cili rregullonte funksionimin e këtij departamenti në Rregulloren e punës së Sekretariatit, të ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2015 është hequr në tërësi. Kjo lë të kuptohet se ky departament nuk ekziston më fare, edhe pse funksionimi i tij është i domosdoshëm për përmbushjen e detyrave të Këshillit.

Sekretariati është kompetent për përpilimin e dy lloj raporteve, ato ditore që përgatiten nga Qendra e Situatave dhe ato periodike që përfshijnë periudha 3-6 dhe 12 mujore e të cilat përgatiten nga Departamenti

¹⁴ Intervistë e Grupit për Ballkan me zyrtar të lartë të Qeverisë së Kosovës, qershor 2022, Prishtinë

¹⁵ Intervistë e Grupit për Ballkan me zyrtar të lartë të Qeverisë së Kosovës, qershor 2022, Prishtinë

¹⁶ Raporti me rekomandime i anëtarëve të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq me datë 29 mars 2018

¹⁷ Intervistë e Grupit për Ballkan me një ish-zyrtar të KSK-së, qershor 2022, Prishtinë

¹⁸ Intervistë e Grupit për Ballkan me një anëtar të KSK-së, maj 2022, Prishtinë

për Analiza dhe Politika të Sigurisë. Këto raporte nuk përmbushin aspak funksionin e tyre sepse janë vetëm përshkruese dhe nuk përmbajnë fare analitikë dhe rekomandime për veprime të mundshme të cilat do të duhej t'i ndërmerre Qeveria e Kosovës.¹⁹

Gjendja e tillë në këto dy njësi të Sekretariatit shpërfaqë mungesën e kapacitetit dhe të investimeve në këtë institucion.

REFORMIMI I ORGANEVE TË KSK-së

Për të adresuar të gjitha këto mangësi si dhe për ta funksionalizuar plotësisht KSK-në duhet të ndërmerren një varg veprimesh politike, ligjore e administrative.

Riorganizimi administrativ i Këshillit të Sigurisë mund të çojë në dy drejtime:

Riorganizimi i Sekretariatit dhe kompetencave të udhëheqësve të tij

Kjo zgjidhje do të implikojë ndryshime minimale ligjore e administrative.

Sekretari i KSK-së është nëpunës civil, ndërsa kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të tij, bëhen në përputhje me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat përkatëse të Rregullores për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil.²⁰ Kjo rregullore përcakton edhe procedurat e vlerësimit të performancës, procedurat disiplinore, kushtet e shkarkimit dhe mundësisë së vazhdimit të funksionit të Sekretarit.²¹

Sekretariati është trup administrativ dhe teknik, i cili zbaton vendimet e Bordit të një organi më të lartë në kuadër të po atij institucioni.

Viteve të fundit praktika ka treguar se zgjedhja e tillë e Sekretarit të KSK-së është përcjellë me probleme ligjore dhe me kontestime të vazhdueshme të kësaj pozite në organe të drejtësisë, duke shkaktuar kështu vështirësi reale në përmbushjen e misionit të këtij organi.

Riorganizimi i Sekretariatit dhe kompetencave udhëheqësve të tij, duke vendosur në krye të tij një person me akt-emërim të drejtpërdrejtë nga kryesuesi i tij, do të mundësonte heqjen e barrierave të komunikimit të drejtpërdrejtë me akterët e tjerë të sektorit të sigurisë.

Pra, Sekretariati do të udhëhiqej nga Drejtori i Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, i cili emërohet drejtpërdrejtë nga Kryeministri dhe i cili njëkohësisht do të jetë edhe Këshilltari Kryesor për Siguri i Kryeministrit. Ai do të udhëheqë edhe me pjesën e politikbërjes si i deleguar i drejtpërdrejtë i Kryeministrit, gjë kjo e cila do të nxisë ndërveprim dhe koordinim më të mirë mes institucioneve. Përveç raportimit të obliguar tek Kryeministri, ai në baza periodike do të informojë edhe Presidentin.

Krijimi i pozitës së zëvendës-drejtorit, është i domosdoshëm për përmbushjen e plotë të detyrave të Sekretariatit. Ai do të jetë nëpunës i lartë civil dhe do të përzgjidhet në pajtim me procedurat e Ligjit për Zyrtarët Publik. Përgjegjësitë e tij do të ishin mbështjetja e punës dhe përmbushja e detyrave të Sekretariatit dhe organeve të tij. Zëvendës-drejtori gjithashtu do të kujdeset për ruajtjen e memories institucionale.

¹⁹ Intervistë e Grupit për Ballkan me një ish- Kryeministër të Republikës së Kosovës, maj 2022, Prishtinë

²⁰ Ligji NR 03/ L-149, neni 15 fq. 6

²¹ Rregullore (QRK)-nr. 06/2012 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, neni 8-12 , fq.7-11

Ruajtja e vazhdimësisë së memories institucionale është esenciale për mbarëvajtjen, funksionimin dhe përmbushjen e plotë të misionit të secilit institucion shtetëror. Memoria institucionale zakonisht përkthehet dhe ruhet brenda institucionit dhe i takon plotësisht organizimit dhe aspektit administrativ të institucionit.

Ndryshimet ligjore që duhet të bëhen tek Ligji për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, të cilat do të adresonin mangësitë e lartcekura, kryesisht kanë të bëjnë me ripërcaktimin e udhëheqjes së Sekretariatit, të cilat rregullohen tek Kreu III i ligjit. Përkatësisht, duhet të ndryshohen dhe plotësohen Neni 16 dhe Neni 17 për Qendrën e Situatave, si dhe të shtohet Neni 18 për Departamentin e Analizave dhe Politikave të Sigurisë (DAPS).

Neni 16 - Roli i Sekretariatit

(Teksti i hijezuar paraqet amandamentet e propozuara)

16.1 Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka Sekretariatit e tij dhe organet tjera mbështetëse, të cilat rregullohen me legjislacionin sekondar.

16.2 Sekretariati do të udhëhiqet nga Drejtori i Sekretariatit të KSK-së, i cili emërohet nga Kryeministri pas njoftimit të Presidentit. Ai gjithashtu udhëheq edhe me Komisionin për Inteligjencë të themeluar nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës.

16.3 Drejtori i Sekretariatit të KSK-së i raporton drejtdrejtë Kryeministrit dhe njëherit shërben si Këshilltar për Siguri i Kryeministrit. Drejtori gjithashtu informon Presidentin në baza periodike.

16.4 Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës po ashtu do të ketë Zëvendëssekretarin (apo Zëvendësdrejtorin) i cili emërohet nga Komisioni për Emërime të Larta Publike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

16.5 Zëvendës sekretari i Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në mungesë të drejtorit apo situata tjera të nevojshme, i raporton drejtpërdrejtë Kryesuesit.

16.6 Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës është përgjegjës për:

- a) përgatitjen e raporteve periodike dhe analizave për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Këshillin e Sigurisë së Kosovës që kanë të bëjnë me çështjet politike të sigurisë;
- b) koordinimin e hartimit të strategjisë dhe politikave të sigurisë në Kosovë, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve profesionale, me miratimin e Qeverisë angazhimin e ekspertëve për periudha të kufizuara vjetore, instrumentet e politikave dhe hulumtimit; dhe
- c) ofrimin e mbështetjes administrative dhe funksionale Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Neni 17 - Qendra e Situatave

(Teksti i hijezuar paraqet amandamentet e propozuara)

17.1 Këshilli i Sigurisë së Kosovës mbështetet nga një Qendër e Situatave e cila i ofron informata të shpejta rreth gjendjes dhe koordinon aktivitetet operacionale në tërë Kosovën. Shërben si qendër operacionale për mbledhjen e informatave, analizave themelore dhe mbështetjes për menaxhim të krizave.

17.2 Të gjitha ministritë relevante, institucionet e sigurisë dhe agjencitë janë të obliguara të ofrojnë informata në kohë për Qendrën e Situatave.

17.3 Qendra e Situatave përveç personelit të SKSK-së përbëhet në mënyrë permanente edhe nga përfaqësuesit e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës, Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit.

Neni 18 - Departamenti i Analizave dhe Politikave të Sigurisë (DAPS)

(Teksti i hijezuar paraqet amandamentet e propozuara)

1. Departamenti i Analizave dhe Politikave të Sigurisë (më tutje DAPS) përmes trajtimit dhe shqyrtimit të strategjive dhe politikave në lëmin e sigurisë, ofron këshilla të paanshme profesionale, për Sekretariatit e KSK-së në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të tyre ligjore, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në lëmitë dhe fushat e caktuara:

1.1. Mbështet zhvillimin, shqyrtimin dhe zbatimin e të gjitha politikave dhe dokumenteve të rëndësishme të politikave të sigurisë;

1.2. Përgatit raporte dhe analiza periodike mbi çështjet e lidhura me politikën dhe sigurinë për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Këshillin e Sigurisë së Kosovës;

1.3. Udhëheq dhe koordinon procesin e draftimit dhe zbatimit të Strategjisë së Sigurisë së Kosovës;

1.4. Asiston në formulimin e rekomandimeve dhe të këshillave për Presidentin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës lidhur me propozimet për përfshirjen e institucioneve dhe agjencive të sigurisë së Kosovës në operacione jashtë territorit të Republikës së Kosovës;

1.5. Përgatit dhe i propozon KSK-së këshillën e kërkuar përmes Sekretarit të KSK-së, për Presidentin e Republikës së Kosovës në fushën e Sigurisë së Kosovës;

1.6. Asiston Drejtorin e Sekretariatit të KSK-së në zhvillimin dhe mbajtjen e kontakteve të niveleve të larta me institucionet qeveritare dhe organizatat tjera të sigurisë për shkëmbimin e informatave;

1.7. Përkujdeset që informacionet e klasifikuara nga KSK dhe organet e tij mbështetëse të përpilohen, shpërndahen, transmetohen dhe ruhen në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;




Fig 3. Struktura e re organizative e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës

Shndërrimi i Sekretariatit të KSK-së në Agjenci ekzekutive brenda Zyrës së Kryeministrit

Shndërrimi i Sekretariatit të KSK-së në Agjenci ekzekutive, fuqizon këtë organ mbështetës të Këshillit si dhe në zbatimin e Ligjit për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Kjo ngritje e nivelit menaxhues i jep autorizimet e munguara drejtuesit të tij, duke e sjellë atë në nivel me përfaqësimin e organeve të tjera të sigurisë brenda Këshillit.

Si Agjenci ekzekutive, kompetencat e menaxhimit rriten, mekanizmi implementues forcohet dhe krijohen mundësitë për rritjen e buxhetit e cila më pas mundëson edhe ngritjen e kapaciteteve operuese brenda institucionit. Gjithashtu ngritja e tillë ie rritë kompetencat e tij për çasje dhe pajisje me informata të cilat janë të domosdoshme për funksionimin e plotë të Këshillit.

Me krijimin e Agjencisë përmirësohet dhe fuqizohet roli i tij në hartimin e politikave të sigurisë, në shërbim të KSK-së. Po ashtu rriten përgjegjësitë dhe kapacitetet e organeve të saj, parimin e ligjshmërisë, profesionalizimit, transparencës dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Agjencia Ekzekutive themelohet për të kryer funksionet administrative brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të Zyrës së Kryeministrit.

Avancimi i statusit administrativ të Këshillit, duke e ngritur atë nga Sekretariati në Agjenci Ekzekutive që vepron në kuadër të zyrës së Kryeministrit, implikon ndryshime më përmbajtësore ligjore e administrative. Për të arritur këtë, nevojiten ndryshimet në Ligjin për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe, pas miratimit të tyre, duhet të miratohet Ligji për Agjencinë si zbatuese e detyrimeve nga ligji paraprak, si dhe aktet nënligjore të cilat rregullojnë më pas organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci.

Ndryshimet dhe plotësimet që duhet të bëhen tek Ligji për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës kryesisht kanë të bëjnë me:

- Shndërrimin e Sekretariatit në Agjenci Ekzekutive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Kjo Agjenci mund të quhet Agjenci për Siguri, Agjenci për Siguri Nacionale apo Kombëtare. Emërtimi i saj nuk duhet të përcaktojë qëllimin për të krijuar një Agjenci që e rritë rolin e KSK-së.

- Ndryshimin e dispozitave kalimtare të cilat kanë të bëjnë me pajisjen e punëtorëve përkatësisht të gjithë anëtarëve të Këshillit me leje përkatëse të sigurisë.

Kapitulli III i Ligjit aktual, rishkruhet në tërësi.

KREU III

MEKANIZMI INSTITUCIONAL PËR MBËSHTETJEN E PUNËS SË KSK-së

Neni 16 - Agjencia për Siguri

(Teksti i hijezuar paraqet amendamentet e propozuara)

Agjencia për Siguri është Agjenci Ekzekutive e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM-së).

Neni 17 - Funksonet dhe përgjegjësitë

(Teksti i hijezuar paraqet amendamentet e propozuara)

1 Agjencia, në fushëveprimin e vet, ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1 Përgatitjen e raporteve periodike dhe analizave për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Këshillin e Sigurisë së Kosovës që kanë të bëjnë me çështjet politike të sigurisë;

1.2 Koordinimin dhe hartimin e strategjisë dhe politikave të sigurisë në Kosovë, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve, instrumenteve të politikave dhe hulumtimit;

1.3 Ofrimin e mbështetjes administrative dhe funksionale për Këshillin e Sigurisë së Kosovës.

Neni 18 - Organizimi i Agjencisë

(Teksti i hijezuar paraqet amendamentet e propozuara)

18.1. Drejtori/ ja e Agjencisë

18.1.1 Agjencia udhëhiqet nga Drejtori/ja ekzekutiv/e i/e Agjencisë i/e cili/a në pajtueshmëri me Ligj, Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm dhe ligjet tjera në fuqi, është përgjegjës/e për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e Agjencisë. Drejtori/ja e ekzekutiv/e Agjencisë do t'i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryeministrit.

18.1.2 Në kryerjen e përgjegjësisë të veta, drejtori/ja e Agjencisë ndihmohet nga një zëvendës drejtor, udhëheqësit e njësisë organizative, këshilltarët dhe personeli me kualifikim të duhur sipas nevojës, në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat e parashtruara me këtë Ligj dhe Rregulloren e Organizimit të Brendshëm.

18.1.3 Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit/ës së Agjencisë bëhet drejtpërdrejtë me vendim të Kryeministrit.

18.1.4. Drejtori/ja i/e Agjencisë emërohet për një mandat katër (4) vjeçar. Riemërimi i tij/saj është diskrecion i Kryeministrit.

18.1.5 Drejtori i Agjencisë duhet të ketë arsimim universitar dhe duhet të emërohet mbi baza të profesionalizmit dhe përvojës së dëshmuar.

18.1.6 Drejtori/ja e Agjencisë shërben si këshilltar i Kryeministrit për çështjet të sigurisë

18.2. Zëvendësdrejtori/ja e Agjencisë

18.2.1. Zëvendësdrejtori/ ja i/e Agjencisë ndihmon drejtorin/ën dhe drejton aktivitetet operationale të njësisë organizative të Agjencisë nën mbikëqyrjen e drejtorit të Agjencisë.

18.2.3. Zëvendësdrejtori/ja i/e Agjencisë është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese, emërohet dhe shkarkohet sipas procedurave të parapara me Ligjin për Zyrtarët Publik.

18.3. Organizimi i brendshëm

18.3.1. Organizimi, strukturimi dhe funksionimi i Agjencisë rregullohen me akt nënligjor të cilin e propozon Agjencia dhe miraton Qeveria.

Kreu i IV i cili ka të bëjë me Dispozitat Përfundimtare dhe Kalimtare, për arsye të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe besueshmërisë rekomandohet ndryshimi i nenit 19 aktual në:

Neni 19 - Kualifikimet për të punësuarit në Agjencinë për Siguri

(Teksti i hijezuar paraqet amandamentet e propozuara)

Përveç kërkesave të zakonshme për punësim në Shërbimin Civil të Kosovës, drejtori/ja i/e Agjencisë, Zëvendësdrejtori/ja dhe të gjithë punëtorët e Agjencisë duhet të pajisen me leje përkatëse për siguri të përcaktuara me ligjin në fuqi.

Propozimet për Ligjin për Themelimin e Agjencisë për Sigurinë Kombëtare dhe aktin nënligjor i cili rregullon organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në këtë Agjenci.

Agjencia për Siguri themelohet me ligj të veçantë nga Qeveria. Agjencia do të ketë kompetenca ekzekutive dhe do të veprojë në kuadër të zyrës së Kryeministrit. Agjencia do të kryej funksionet administrative dhe do të zbatoj plotësimet dhe ndryshimet e paraqitura më lartë në Ligjin për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Përveç dispozitave të përgjithshme në ligj duhet të trajtohen edhe :

- Fusha e veprimit të Agjencisë
- Organizimi dhe administrimi i Agjencisë
- Bashkëpunimi brenda qeveritar
- Punonjësit e Agjencisë duke përfshirë specifikat e kualifikimeve
- Buxheti

Më pas bazuar në Ligjin për Themelimin e Agjencisë për Sigurinë Kombëtare, kërkohet edhe miratimi i **Rregullores për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Sigurinë Kombëtare**. Qëllimi i kësaj rregulloreje duhet të jetë përcaktimi i përgjegjësive dhe organizimi i brendshëm i Agjencisë.

Agjencia për Sigurinë (Kombëtare) do të ketë këtë përbërje:

Zyra e Drejtorit/ës

Zyra e Zëvendësdrejtorit/es

Qendra e Situatave

Departamenti për Analiza të Politikave të Sigurisë

Departamenti për Legjislacion

Departamenti për Administratë, Buxhet dhe Financa

Përgjegjësitë dhe detyrat e secilit departament duhet përpiluar me kujdes duke adresuar të gjitha mangësitë e paraqitura më parë përderisa aspekti administrativo-operacional ka qenë i rregulluar si Sekretariat.




Fig 2. Struktura organizative e Agjencisë për Sigurinë Kombëtare

Nga shembujt në vijim mbi funksionimin e Këshillit të Sigurisë në vendet e tjera, mund të shohim funksionimin e tyre dhe Sekretariateve apo zyrave mbështetëse të tyre, të cilat kanë shërbyer në analizën për politikat e propozuara dhe të shqyrtuara më lartë për rastin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

FUNKSIONIMI I KËSHILLIT TË SIGURISË NË VENDET TJERA

Roli i Këshillit të Sigurisë ndryshon nga shteti në shtet. Në vendet me sistem presidencial, Këshilli i Sigurisë udhëhiqet nga Presidenti dhe në këto raste roli i tij është më i theksuar. Në vendet me sistem parlamentar ka dy lloje të udhëheqjeve: në disa vende me sistem të tillë Këshilli i Sigurisë udhëhiqet nga presidenti kurse në disa raste tjera nga kryeministri.

Si model i mirëfilltë i funksionimit të Këshillit të Sigurisë në sistem presidencial është modeli i **ShBA-ve**. Ky këshill është ndër institucionet e para të këtij lloji në botë. Është themeluar në vitin 1947 dhe udhëhiqet nga Presidenti i ShBA-ve.²² Roli i tij është që të këshillojë, mbështesë dhe ndihmojë Presidentin e ShBA-së në çështjet e sigurisë, mbrojtjes kombëtare dhe politikës së jashtme.

Spektori i sigurisë në **Kroaci** përbëhet nga disa institucione, por më të rëndësishmet janë Këshilli i Sigurisë Kombëtare dhe Këshilli për Koordinimin e Shërbimeve të Sigurisë dhe Inteligjencës. Që të dy, për nga aspekti administrativ si dhe ai i ekspertizës, mbështeten nga Zyra e Këshillit të Sigurisë Kombëtare.²³ Roli kryesor i kësaj zyre është krijimi dhe përpilimi i raporteve periodike, në bazë të të dhënave të cilat i marrin nga agjencitë e sigurisë dhe inteligjencës, si dhe dhënia e vlerësimeve strategjike për Presidentin dhe Kryeministrin e vendit. Zyra e Këshillit të Sigurisë Kombëtare gjithashtu është autoriteti i cili koordinon, harmonizon miratimin dhe kontrollon zbatimin e masave dhe standardeve të sigurisë së informacionit në Republikën e Kroacisë.




Fig 3. Organogrammi i Strukturës së Këshillit të Sigurisë së Kroacisë²⁴

Këshilli i Sigurisë Kombëtare të Kroacisë e udhëheqin bashkërisht Presidenti dhe Kryeministri i vendit, me ç'rast edhe agjenda e takimeve dhe temat e diskutimit përcaktohen në koordinim të plotë mes këtyre dy institucioneve. Vlen të theksohet se anëtar i Këshillit të Sigurisë në Kroaci është edhe Kryetari i Kuvendit.²⁵

²² Për më shumë detaje, vizitoni <http://www.state.gov/documents/organization/15538.pdf>

²³ Për më shumë detaje, vizitoni <https://www.uvns.hr/en/about-us/introduction>

²⁴ Për më shumë detaje, vizitoni <https://www.uvns.hr/hr/o-nama/shema-uvns-u-sigurnosno-obavjestajnom-sustavu-rh>

²⁵ Për më shumë detaje, vizitoni <https://www.uvns.hr/UserDocsImages/dokumenti/nacionalna-sigurnost/ZAKON-O-SIGURNOS-NO-OBAVJESTAJNOM-SUSTAVU-RH-NN-79-2006.pdf>

Këshilli i Sigurisë Kombëtare të **Slovenisë** është organ këshillues dhe koordinues i Qeverisë. Si i tillë ai ofron këshilla lidhur me mbrojtjen kombëtare, sistemin e sigurisë, sistemin e sigurisë ndaj emergjencave dhe për çështje të tjera që i përkasin fushës së sigurisë. Këshillin e kryeson Kryeministri i vendit. Ofrimin e mbështetjes administrative dhe teknike për Këshillin, Sekretariatit dhe Grupin Ekzekutiv të Sekretariatit e bën Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Krizave të Republikës së Slovenisë, e cila operon brenda Ministrisë së Mbrojtjes.²⁶ Sekretariati i Këshillit udhëhiqet nga Sekretari i Shtetit i cili njëkohësisht është edhe këshilltar për çështje të sigurisë i Kryeministrit.

Këshilli i Sigurisë Kombëtare në Republikën **Çeke** është organ i përhershëm i Qeverisë. Kryesohet nga Kryeministri ndërkaq për zëvendës ka Zëvendëskryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme. Në përbërje ka gjithsej 9 anëtarë, ku përveç pjesëtarëve të Qeverisë, në mbledhje marrin pjesë edhe Guvernatori i Bankës Kombëtare Çeke, Presidenti i Administratës së Rezervave Materiale Shtetërore, Menaxheri i Zyrës së Qeverisë së Republikës Çeke dhe Drejtori i Seksionit të Kryeministrit. Mandati i këtyre anëtarëve është i njëjte me mandatin e qeverisë.²⁷ Aktivitetet e administrative organizohen nga Sekretariati i Këshillit i cili njëkohësisht është edhe Departament i Mbrojtjes dhe Sigurisë i Zyrës së Qeverisë së Republikës Çeke.

Sa u përket vendeve fqinje, vlen të përmenden mënyra e funksionimit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të **Shqipërisë**, Malit të Zi, Republikës së Maqedonisë Veriore dhe Serbisë. Këshillin Kombëtar të Shqipërisë e udhëheq Presidenti. Roli kryesor i këtij organi është diskutimi dhe dhënia e këshillave për Presidentin si Komandant i Forcave të Armatosura.²⁸ Këshilli përbëhet nga 14 anëtarë: Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Drejtësisë, Ministrit i Punëve të Brendshme, Ministri i Financave, Ministri i Transportit, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Energjisë, Kryetari i Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.²⁹

Këshilli për Siguri Kombëtare në Republikën e **Malit të Zi** kryesohet nga Kryeministri. Në përbërjen e tij ka 9 anëtarë, Kryeministri, Zëvendëskryeministri për çështje të sistemit politik dhe politikave të jashtme e të brendshme, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Financave, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Integriteteve Evropiane, Drejtori i Agjencisë për Sigurinë Nacionale si dhe Kryetari dhe Nënkryetari i Komisionit Parlamentar për Mbrojtje dhe Siguri.³⁰ Pjesa administrative e punës së këtij këshilli është kompetencë e Byrosë për Koordinim Operativ.³¹ Kjo Byro përbëhet nga Drejtori i Agjencisë për Sigurinë Nacionale, Shefi i Shtabit të Ushtrisë së Malit të Zi, Drejtori i Policisë, Drejtori i Drejtorisë për Parandalimin e Pastrimit të Parasë dhe Financimit të Terrorizmit, Drejtori i Doganave, Drejtori i Administratës Tatimore, Drejtori i Drejtoratit për Informacione Ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtori i Drejtoratit për Siguri të Brendshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Sekretari i Këshillit.³² Të gjithë këta, përfshirë edhe vetë Këshilli, emërohen me vendim nga Qeveria. Funksionet e tjera administrative kryhen nga Sekretariati i Këshillit për Siguri Kombëtare.

Këshilli i Sigurisë është trupi më i lartë këshillëdhënës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që i shqyrton

²⁶ Për më shumë detaje, vizitoni <https://www.gov.si/en/policies/defence-civil-protection-and-public-order/national-security/>

²⁷ Për më shumë detaje, vizitoni https://www.vlada.cz/assets/ppov/brs/statut-brs-aj_1.pdf

²⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 168, pika 2, fq 53

²⁹ Ligji për Pushtet dhe Autoritetet e Drejtimit e të Komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, neni 10, fq 4 https://www.mod.gov.al/images/aktelitore/ligjipushteteve/Ligj_nr_64_2014_azhornuar.pdf

³⁰ “Zakoni o osnovama obavještajno bezbjednosti sektora crne gore” mars 2017, Neni 8, <https://zakoni.skupstina.me/zakoni/web/dokumenta/zakoni-i-drugi-akti/131/1406-8943-24-5-17-1.pdf>

³¹ “Zakoni o osnovama obavještajno bezbjednosti sektora crne gore” mars 2017, Neni 15, <https://zakoni.skupstina.me/zakoni/web/dokumenta/zakoni-i-drugi-akti/131/1406-8943-24-5-17-1.pdf>

³² Zakoni o osnovama obavještajno bezbjednosti sektora crne gore” mars 2017, Neni 15, <https://zakoni.skupstina.me/zakoni/web/dokumenta/zakoni-i-drugi-akti/131/1406-8943-24-5-17-1.pdf>

çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës dhe u jep propozime Kuvendit dhe Qeverisë. Mënyra e punës së Këshillit të Sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, mënyra e realizimit të të drejtave dhe përmbushjes së detyrave të anëtarëve të Këshillit, konvokimi dhe mbajtja e mbledhjeve, zbatimi i qëndrimeve të marra, iniciativat e ngritura dhe mendimet dhe propozimet e dhëna, informimi mbi punën e vet, si dhe çështjet e tjera në lidhje me organizimin e mënyrës së punës së Këshillit, përcaktohen me Rregulloren e Punës së Këshillit të Sigurimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Anëtarë të Këshillit të Sigurisë në Republikën e Maqedonisë Veriore janë Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministri i Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe tre ekspertë të fushës së sigurisë të cilët i emëron Presidenti.³³ Zyra administrative e Këshillit operon brenda strukturës organizative të Zyrës së Presidentit.

Në rastin e **Serbisë**, Këshilli i Sigurisë është i autorizuar të këshillojë, diskutojë, vlerësojë dhe koordinojë aktivitetet e të gjitha mekanizmave të sigurisë në Serbi. Pavarësisht se Këshilli udhëhiqet nga Presidenti, rendi i ditës përgatitet bashkërisht nga Presidenti dhe Kryeministri i Serbisë. Mirëpo, sekretariati i Këshillit të Sigurisë vepron brenda Zyrës së Presidentit dhe udhëhiqet nga shefi i kabinetit të Presidentit³⁴.

³³ Për më shumë detaje vizitoni : <https://pretsedatel.mk/al/keshilli-i-sigurimit/>

³⁴ Për më shumë detaje, vizitoni https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_osnovama_uredjenja_sluzbi_bezbednosti_republike_srbi je.html

PËRFUNDIME

Këshilli i Sigurisë së Kosovës paraqet një ndër organet më të rëndësishme të sektorit të sigurisë në vend. Detyrë parësore e tij është vlerësimi i gjendjes së sigurisë, rekomandimi dhe këshillimi i institucioneve të vendit lidhur me kërcënimet dhe rreziqet e mundshme. Roli i KSK-së është jetik për suksesin apo dështimin gjatë ballafaqimit me rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë së vendit. Anashkalimi dhe strukturimi i gabuar i Sekretariatit të KSK-së e kanë shndërruar atë institucion në institucion jo funksional i cili nuk përmbushë qëllimin e krijimit të tij.

Vlerësimet e deri tanishme kanë treguar se ekziston një mungesë e koordinimit mes akterëve përbërës të KSK-së. Kjo mungesë e koordinimit do të mund të zgjidhej me anë të një riorganizimi administrativ e operacional të organeve mbështetëse të KSK-së.

Udhëheqja apo koordinimi i punës së këtyre organeve mbështetëse dhe ngritja e nivelit të tyre për nga hierarkia ekzekutive, nga personi i cili emërohet dhe i përgjigjet drejtpërdrejtë kryesuesit të KSK-së, përkatësisht Kryeministrit, do të ndihmonte në organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta të institucioneve të sigurisë. Raportimi i përbashkët i këtyre institucioneve do të krijonte një koordinim ndërinstitutional shumë më efikas.

Një organizim i tillë administrativo – operacional do të mundësonte edhe rritjen e besueshmërisë së institucionit, ndërtimin e kapaciteteve njerëzore të përgatitura, të cilat më pas do të arrinin të përmbushnin detyrat dhe funksionet e KSK-së.

Krijimi i resurseve të mjaftueshme dhe me ekspertizë adekuate, do të mundësonte përpilimin e raporteve të cilat identifikojnë rreziqet, ofrojnë zgjidhje dhe rekomandime për Qeverinë e në këtë mënyrë ndihmojnë edhe në zhvillimin e politikave të mirëfillta të sigurisë së vendit.

Grupi për Hulumentimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është një organizatë e pavarur rajonale, me qendër në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza dhe rekomandime të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlidhura me shtet-ndërtim; konsolidim institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integrimin Evropian dhe reformave politike. Ne kemi përvojë në hartimin, raportimin dhe zhvillimin e politikave, qasje strategjike dhe avokim me qeverinë, institucione ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportet tona rigorozë, të detajuar dhe të paanshme, të bazuara gjithmonë në hulumtimet në terren. Ne shkojmë përtej qëndrimeve kryesore dhe kërkojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika të cilat janë krijuese, të realizueshme dhe të matshme, për të ndihmuar në zhvillimin e demokracive të forta dhe shoqërive të bazuara në sundimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor.

Ne angazhohemi në avokim të nivelit të lartë, si në rajon ashtu edhe ndërkombëtarisht, duke ndikuar njëkohësisht në diskutime mbi politikën, punët e brendshme dhe politika evropiane për Ballkanin Perëndimor.

Për të arritur këtë, Grupi për Ballkan ka dizajnuar instrumente dhe platforma të reja:

Dialogu Politik promovon dialogun e brendshëm të Kosovës, dhe agjendën e krijimit të reformave.

Forumi i Politikave (një Forum i Avokimit të Nivelit të Lartë-Mendimtar) u angazhua për të përmirësuar dialogun midis shoqërisë civile dhe institucionale.

Grupi për Avokim dhe Politika Kosovë-Serbi (një Forum për bashkëpunimin ndërkufitar të shoqërisë civile) synon të komunikojë, promovojë dhe forcojë dialogun drejt normalizimit të plotë midis Kosovës dhe Serbisë, dhe shoqërive të tyre.

Gratë në politikë promovon fuqizimin e grave dhe vajzave; sigurinë dhe gjithë-përfshirjen e tyre; dhe angazhohet të forcoj ndikimin e Grupit të Grave në tërë Kosovën.

Platforma për Dialogun promovon procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke informuar publikun më të gjerë dhe duke nxitur debat për marrëveshjet, përfitimet dhe sfidat e Dialogut.

Komponenti i Mbështetjes nga Eksportët siguron mbështetje për qeverinë dhe institucionet kryesore në fushat e politikave, paqes dhe agjendat e shtet-ndërtimit.



Norwegian Embassy

www.balkansgroup.org